

Mazars Sh.p.k.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	40,809,903	10,285,871
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	22,002,290	34,047,824
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,387,486	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,105,432	2,458,213
Shpenzime të shtyra	8	10,326,104	10,347,456
Total Aktive Afatshkurtra		75,631,215	57,139,364
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	5,755,794	4,737,500
Aktive afatgjatë jomateriale	10	281,639	370,751
Total aktive afatgjatë		6,037,433	5,108,251
Total Aktive		81,668,648	62,247,615
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	1,554,627	1,396,210
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	1,682,551	-
Detyrime tatimore	13	8,667,623	4,842,677
Të ardhurat e shtyra	14	538,834	-
Të tjera detyrime	15	17,639,012	9,128,963
Total Detyrime afatshkurtra		30,082,647	15,367,850
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	16	44,416,714	44,268,748
Të tjera detyrime		2,127,840	2,172,170
Total Detyrime afatgjatë		46,544,554	46,440,918
Totali i detyrimeve		76,627,201	61,808,768
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		328,847	-
Fitimi i ushtrimit		4,602,600	328,847
Total kapitali aksionar		5,041,447	438,847
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		81,668,648	62,247,615

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	98,856,265	53,846,441
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	(875,050)	1,130,139
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(16,853,218)	(15,368,334)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(7,568,253)	(7,558,678)
2) Të tjera shpenzime	21	(9,284,965)	(7,809,656)
Shpenzime të personelit	22	(68,902,958)	(34,777,196)
1) Paga dhe shpërblime		(65,229,540)	(33,141,410)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetsore		(3,673,418)	(1,635,786)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9/10	(1,329,573)	(894,352)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(5,015,712)	(2,559,728)
Të ardhura e tjera			
Shpenzime financiare	24	656,258	(178,412)
Shpenzime interesi dhe shpenzime			
1) të ngjashme		5,916	2,818
2) Shpenzime të tjera financiare		650,342	(181,230)
Fitimi/humbja para tatimit		6,536,012	1,198,558
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(1,933,412)	(869,711)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		(1,933,412)	(869,711)
Fitimi/humbja e vitit		4,602,600	328,847
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		4,602,600	328,847

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mazars sh.p.k.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	100,000	10,000	18,810,412	3,922,498	22,842,910
Fitimi / Humbja e vitit				328,847	328,847
Dividendë të paguar			(18,810,412)	(3,922,498)	(22,732,910)
					-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	100,000	10,000	-	328,847	438,847
Fitimi / Humbja e vitit				4,602,601	4,602,601
Lëvizjet përmes kapitalit			328,847	(328,847)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	10,000	328,847	4,602,600	5,041,447

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Mazars sh.p.k më 25/03/2016 dhe janë firmosur si më poshtë.



Teit Gjini

Administrator

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al



Bernard Cumashi

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	4,602,600	328,847
Shpenzimet financiare jomonetare	9,792	302,048
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	1,552,965	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,329,573	894,352
Nxjerrja jashtë përdorimit e AAM		387,386
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	11,200,676	(14,044,404)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	5,103,389	67,518
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	8,889,948	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	32,688,943	(12,064,253)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,258,755)	(3,121,522)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,258,755)	(3,121,522)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	753,977	37,441,955
Dividendë të paguar	-	(22,732,910)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	753,977	14,709,045
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	31,184,165	(476,730)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	10,285,871	10,883,419
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(660,133)	(120,818)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 40,809,903	10,285,871

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Mazars" sh.p.k (ish-Gjini Consulting sh.p.k) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 17 Maj 2003 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria "Gjini Consulting" sh.p.k u bë anëtar plotësisht i integruar në partnershipin Global të MAZARS që prej datës 1 janar 2015, dhe që prej kësaj date emri i saj është "Mazars" sh.p.k.

Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore me NIPT K32123006W.

Selia e shoqërisë është në RR"Emin Duraku' Pall"Binjaket", Nr 5, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë nominale 100,000 LEK i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 leke.

Mazars Sh.p.k është një shoqëri shqiptare, e zotëruar nga ortakët:

- Z.Teit Gjini, zotërues i 50 kuotave ose 50% të kapitalit të shoqërisë
- Znj.Irena Pulo, zotëruese e 5 kuotave ose 5% të kapitalit të shoqërisë
- Znj.Diana Ylli, zotëruese e 45 kuotave ose 45% të kapitalit të shoqërisë

Administrator i shoqërisë është Z. Teit Gjini

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është Kryerja e Shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC. Kryerja e Shërbime të kontabilitetit, Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore , hartimi i pasqyrave financiare etj.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 25 punonjës (2014: 11 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23
GBP/LEK	186.59	179.48

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Mjete monetare në bankë	40,667,448	10,285,871
Llogari rrjedhëse	40,667,448	10,285,871
Mjete monetare në arkë	142,455	-
Totali	40,809,903	10,285,871

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Klientë	27,002,290	34,047,824
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(5,000,000)	
Totali	22,002,290	34,047,824

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Gjendja më 1 Janar		
Rimarrje për vitin 2015		
Zhvlerësimi për vitin 2015	5,000,000	
Gjendja më 31 Dhjetor 2015		
Totali	5,000,000	-

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të Arkëtueshme tregtare nga Mazars group	100,957	-
Të Arkëtueshme të tjera nga Mazars group	1,286,529	
Totali	1,387,486	-

7. Të tjera llogari të arkëtueshme afatshkurtra

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Tatim Fitimi	-	831,505
Fond Garanci për Zyrat	777,920	794,127
Tatim në burim	3,012	22,060
Pëfitime afatshkurta nga sigurimet	19,834	417,794
Të tjera	304,666	392,727
Totali	1,105,432	2,458,213

8. Parapagimet dhe Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime të periudhave të ardhme	10,326,104	10,347,456
Totali	10,326,104	10,347,456

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	2,154,200	1,424,977	749,120	4,328,297
Shtesa	2,004,221	116,523	1,000,778	3,121,522
Nxjerrje jashtë përdorimit	(487,708)		(131,583)	(619,291)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	3,670,713	1,541,500	1,618,315	6,830,528
Shtesa	1,118,910	980,799	159,046	2,258,755
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	4,789,623	2,522,299	1,777,361	9,089,283
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	(834,474)	(412,174)	(273,044)	(1,519,692)
Amortizimi i vitit	(368,707)	(251,600)	(184,934)	(805,241)
Nxjerrje jashtë përdorimit		176,027	55,878	231,905
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	(1,203,181)	(487,747)	(402,100)	(2,093,028)
Amortizimi i vitit	(639,377)	(337,012)	(264,072)	(1,240,461)
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	(1,842,558)	(824,759)	(666,172)	(3,333,489)
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	1,319,726	1,012,803	476,076	2,808,605
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	2,467,532	1,053,753	1,216,215	4,737,500
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	2,947,065	1,697,540	1,111,189	5,755,794

10. Aktive Afatgjata Jo-Materiale

	Programe	Totali
Kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	594,073	594,073
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	594,073	594,073
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	594,073	594,073
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	134,211	134,211
Amortizimi i vitit	89,111	89,111
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	223,322	223,322
Amortizimi i vitit	89,112	89,112
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	312,434	312,434
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	459,862	459,862
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	370,751	370,751
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	281,639	281,639

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitorë vendas	1,518,707	1,353,290
Furnitorë të huaj	-	-
Furnitorë për fatura të pa mbëritura	35,920	42,920
Totali	1,554,627	1,396,210

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Llogari të pagueshme tregtare	1,682,551	-
Totali	1,682,551	-

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	497,658	241,588
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	5,800,987	2,931,731
Tatim në Burim	41,217	
Tatim fitimi	721,460	-
TVSH për t'u paguar	1,606,301	1,669,358
Totali	8,667,623	4,842,677

14. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Parapagim nga klient	538,834	-
Totali	538,834	-

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjeramë 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Detyrime ndaj personelit	17,367,118	8,477,170
Debitorë & kreditorë të tjerë	271,894	651,793
Totali	17,639,012	9,128,963

16. Llogari afatgjata të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë afatgjatatë pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Finacim T.G	39,523,394	39,924,408
Finacim D.Y	2,446,660	2,172,170
Finacim I.H	2,446,660	2,172,170
Totali	44,416,714	44,268,748

17. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërise është 100,000 LEK I zotëruar si më poshtë përkatësisht për vitet 2015 dhe 2014:

Aksioneri	Kuotat	31 dhjetor 2015			Kuotat	31 dhjetor 2014		
		Vlera nominale /kuotë	Vlera nominale	%		Vlera nominale /kuotë	Vlera nominale	%
Teit Gjini	50	1,000	50,000	50%	100	1,000	100,000	100%
Irena Hoxha	5	1,000	5,000	5%				
Diana Ylli	45	1,000	45,000	45%				
Total	100		100,000	100%	100		100,000	100%

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga shërbimet	98,856,265	53,846,441
Totali	98,856,265	53,846,441

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	99,615,981
Parapagime	(538,834)
Diferencë kursi nga parapagimet	(53)
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	99,077,095
Shërbime	98,856,265
Të tjera	220,830
Te ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	99,077,095
Të ardhurat nga interesat	5,936
Fitim nga këmbimet valutore	1,029,167
Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Ftimit	100,112,198

19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera jo-kryesore dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitime nga këmbimet valutore	252,009	160,573
Humbje nga këmbimet valutore	(1,347,889)	(229,087)
Të ardhura nga të tretët për venien e ambjenteve në dispozicion	220,830	1,198,653
Totali	(875,050)	1,130,139

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime materiale konsumi	463,361	400,923
Nënkotraktore	663,967	2,949,465
Royalties dhe shërbime teknike	1,300,789	-
Qera Zyra	3,351,040	2,685,248
Shpenzime për përshtatje Zyra	1,136,933	-
Qera Makina	-	1,200,000
Kuota antarësimi në IEKA	652,163	323,042
Totali	7,568,253	7,558,678

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	2,519,536	1,821,933
Shpenzime utilitare dhe mirmbajtje	1,441,999	1,957,289
Shpenzime për pritje	1,153,213	772,900
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	827,478	640,019
Prime sigurimi	536,656	45,559
Komisione bankare	280,328	211,652
Trajnime dhe kualifikime	202,364	131,414
Vlera kontabël e aseteve të dala jashtë përdorimi	-	387,387
Promocione	907,813	-
Qera ambjenti	262,500	-
Anëtarësime dhe abonime	85,405	109,222
Të ndryshme	1,067,673	1,732,281
Totali	9,284,965	7,809,656

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për paga	65,229,540	33,141,410
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	3,673,418	1,635,786
Totali	68,902,958	34,777,196

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 25 (2014:11).

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Gjoba dhe penalitete	15,712	40,000
Humbje nga mos arkëtimet e klientëve	-	2,519,728
Provizion për zhvlerësim të të drejtave për arkëtim	5,000,000	
Totali	5,015,712	2,559,728

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për interesa	5,916	2,818
Të ardhura nga interesat	-	-
Humbje nga këmbimet valutore	(126,816)	(193,942)
Të ardhura nga këmbimet valutore	777,158	12,712
Totali	656,258	(178,412)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	6,536,012	1,198,558
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	6,353,402	4,599,516
Shpenzime pritje & përcjellje	968,742	612,813
Penalitet, gjopa e dëmshpërblime	15,712	40,000
Provizion zhvlerësim kërkesa të arkëtueshme	5,000,000	
Shpenzime të viteve të kaluara		56,250
Humbje nga mos arkëtimet e klientve		2,519,728
Shpenzime të tjera pa dokumenta të regullt tatimore	368,948	1,370,725
<i>Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura)</i>	12,889,414	5,798,074
<i>Tatim fitimi @15%</i>	1,933,412	869,711
Fitimi I Vitit	4,602,600	328,847

26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
Finacim T.G	39,523,394	39,924,408
Finacim D.Y	2,446,660	2,172,170
Finacim I.H	2,446,660	2,172,170
Mazars Scrl	1,300,789	
Mazars Kft	381,762	
	46,099,265	44,268,748
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
Mazars scrl	1,387,486	
	1,387,486	-

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Blerje nga palët e lidhura		
Mazars Scrl	1,300,789	
Mazars Kft	387,950	
Totali	1,688,739	-

27. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

28. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.